

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Masa e sigurisë për shafen e SHISH, Berisha: Rama po përpiqet ta minimizojë çështjen - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/berisha-sulmon-ramen-per-ceshtjen-hyseni-po-perpiqet-ta-minimizoj/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:55:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 16:54:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cf49dc2bccfa70661e0b7ec62f3e326f202a0783e644fe44aa63b811e72f234c
TEKSTI	4f38955b34c9441042170542fed4daf75eda94990cb9e4f694e42cdd28f77590
PAMJA	bfd76912b74a9b72f09ef70053ebd30a636bbe0503454f421086cef9ee481f4f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	34be5c1ac2861cd30f6d609731b27a70a5786d8e28b4a8eb74ea79dba7785f36
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/34be5c1ac2861cd30f6d609731b27a70a5786d8e28b4a8eb74ea79dba7785f36>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Donald Trump SHBA Asambleja e OKB Lufta në Ukrainë Sali Berisha

LAJM KRYESOR | POLITIKË

Masa e sigurisë për shafen e SHISH, Berisha: Rama po përpiqet ta minimizojë çështjen

LAJMI I FUNDIT

20:28 Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu

20:16 Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës

20:11 Trump zbulon marrëveshje aksionesh me vlerë miliona dollarë në industrinë e teknologjisë dhe AI

20:05 Shtetet Baltike i kërkojnë BE-së 500 milionë euro për mbrojtjen kundër dronëve

18:51 Moska refuzon armëpushimin, SHPERNDAJË
ARTIKULLIN Lavrov: Rusia nuk do t'i ndalë luftimet

19:37 E ardhmja e Merz në pikëpyetje, gati gjysma e votuesve kërkojnë zgjedhje të reja

23 Shtator 2026 | 18:54

Kryedemokrati Sali Berisha akuzoi nga mbledhja e kryesisë së PD-së kryeministrin Edi Rama se po përpiqet të mbrojë ish-drejtuesen e SHISH, Vlora Hyseni, pas nisjes së hetimeve të SPAK ndaj saj.

Kryedemokrati akuzoi gjithashtu prokurorinë se nuk e ka cilësuar Hysenin si anëtare të një grupi të strukturuar kriminal, duke iu referuar akuzave për nxjerrje të sekretit shtetëror dhe ndihmë të një personi të dyshuar për veprimtari kriminale.

Sipas Berishës, Rama po përpiqet që komunikimet e bëra publike t'i paraqesë si një "afërë dashurie", ndërsa pretendoi se Hyseni "çdo hap, çdo vendim e ka bërë me dijeni dhe porosi të Edi Ramës".

"Edi Rama, duhet të jeni të sigurt se ka qenë i informuar, ai dhe jo vetëm ai, urdhër arresti për drejtuesen e SHISH, shërbim që funksionon në një sistem bashkëpunimi të ngushtë në kuadrin e NATO-s, shërbim që në traditën e tij, ka një bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë më kryesorë në fushën e sigurisë, shërbim real dhe me kontribute të pamohueshme. Pra, përpiqet ta paraqesë sot me ca transkripte si një afërë dashurie (love affair). E vërteta është se Vlora Hyseni çdo hap, çdo vendim e ka bërë me dijeni dhe porosi të Edi Ramës", tha ai.

Ai e akuzoi Hysenin se ka cënuar besimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe pretendoi se ajo kishte pasur si synim të vepronte kundër Kosovës, duke iu referuar edhe shkarkimit të saj të mëparshëm nga Agjencia e Inteligjencës së Kosovës.

"Qëndrimi i Hysenit është shkelim flagrant edhe i besimit të partnerëve tanë. S'ka gjë më të turpshme, njeriu që kishte urat e bashkëpunimit me shërbimet më serioze, ishte një skllave mjerane e mafies shqiptare dhe e Ergys Agasit", tha Berisha.

Duke iu drejtuar kryeministrit Rama, Berisha e cilësoi atë "padrino", duke pretenduar se kreu i qeverisë po përpiqet ta minimizojë çështjen.

TESTIM

“Nëse këta janë pisa, ti je kryepis, nëse këta janë llum, ti je kryellum, nëse këta janë mafie, ti je padrino që bën sikur kjo nuk ishte ndonjë gjë e madhe. Ajo atje kishte gjithë sekretet e shtetit dhe NATO-s që vinin në këtë shtet”, vijoi Berisha.

Berisha bën thirrje për pjesëmarrje në protestë: Opozita të vijojë aksionin, jo bojkot të Parlamentit

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | EURONEWS ALBANIA | LAJM KRYESOR | VENDI

Kapet në Rusi ‘bosi’ shqiptar i ‘kartelit’ te drogës Shpëtim Aliu

Është arrestuar në Rusi, me qëllim ekstradimi, Shpëtim Aliu, i njohur edhe me emrin Salvatore, i shpallur në kërkim nga SPAK si drejtues i një...

20:28 | 23/09/2026

BOTA | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT

Meloni mungon në Asamblenë e OKB-së, pikëpyetje për përplasjen me Trumpin

Kryeministria italiane Giorgia Meloni i dha fund një periudhe prej gati 15 vitesh, gjatë së cilës ajo mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së,...

19:36 | 23/09/2026

LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Komisioni European: Negociatat me Shqipërinë për në BE drejt mbylljes në dhjetor 2027

Komisioni pritet të mbështesë zyrtarisht afatin e anëtarësimit të Shqipërisë në vitin 2027 në një plan të ri veprimi, i cili pritet të përfshijë gjithashtu...

17:30 | 23/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontaktoni

Follow Euronews on all platforms: